

## **Rezoluta mbi Shqipërinë e paraqitur nga Partia Demokratike e Shqipërisë (PD) në Asamblenë Politike të PPE-së**

**Duke konsideruar** vullnetin e fortë dhe aspiratat europiane të popullit shqiptar dhe të partive shqiptare anëtare të PPE-së;

**Duke njohur** rezultatin e konferencës së dytë ndërqeveritare me Shqipërinë, të mbajtur më 15 tetor 2024, e cila shënoi hapjen e negociatave për grupin e parë të kapitujve themelorë me vendin;

**Duke iu referuar** Raportit Përfundimtar të OSBE/ODIHR mbi Zgjedhjet Vendore në Shqipëri (2023) dhe Zgjedhjet Parlamentare 2021[1];

**Duke iu referuar** Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International për 2023[2]; Indeksit të Projektit Botëror të Drejtësisë 2024[3]; Raporteve të Departamentit të Shtetit të SHBA mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut: Shqipëria 2023[4];

**Duke pasur parasysh** që PPE mirëpriti vendimin e Këshillit European për hapjen e negociatave për Klasterin 1 me Shqipërinë, të kushtëzuar nga zbatimi i reformave të nevojshme demokratike;

**PPE shpreh shqetësimet e saj lidhur me:**

Gjendjen e **integritetit institucional**, të pasqyruar në korrupsionin endemik dhe mungesën e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme sipas standardeve të OSBE-së;

**Përballjen e vazhdueshme politike**, duke shprehur shqetësim për zvogëlimin e hapësirës për rolin mbikëqyrës parlamentar të opozitës; nxit angazhimin për dialog dhe forcimin e institucioneve e procedurave demokratike përmes bashkëpunimit ndërpartiak dhe brendapartiak konstruktiv, respektit të ndërsjellë, konsultimeve gjithëpërfshirëse me shoqërinë civile dhe vendimmarrjes transparente;

Mungesën e ndërtimit të një kulture parlamentare konstruktive përmes nxitjes së konsensusit ndërmjet të gjithë aktorëve politikë dhe **respektimit të të drejtave e përgjegjësisive të opozitës**;

Pamjaftueshmërinë për të siguruar **funksionimin e duhur të institucioneve demokratike** në vend, përfshirë pluralizmin e qëndrueshëm, opozitën konkurruese dhe dialogun politik të brendshëm dhe ndërpartiak;

Çdo **përndjekje të pretenduar politike të liderëve të opozitës**, deputetëve dhe zyrtarëve vendorë, duke u përballur me kufizime të motivuara politikisht të të drejtave të tyre civile;

**Lidhjet ndërmjet trafikut të drogës dhe krimit të organizuar**

**me elitën politike** dhe zyrtarët e zbatimit të ligjit, duke shfrytëzuar ekonominë dhe kuadrin politik të Shqipërisë për pastrim parash;

**Dështimin për të arritur një marrëveshje mbi reformën zgjedhore**, duke sjellë progres minimal në zbatimin e rekomandimeve të papërfunduara nga OSBE/ODIHR dhe Komisioni i Venecias, duke kujtuar se të gjitha palët ranë dakord për ndryshimet zgjedhore që lejojnë, në veçanti, votimin nga jashtë. Këto synonin përmbushjen e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese;

**Përkeqësimin e ndjeshëm të peizazhit politik** teksa afrohen zgjedhjet parlamentare të vitit 2025, të shënuar nga standarde të dobësuar zgjedhore dhe duke kujtuar paligjshmërinë e përdorimit të burimeve publike gjatë fushatave zgjedhore;

Kwto veprime që kanë **zvogëluar më tej të drejtat kushtetuese të opozitës në Parlament**, duke reflektuar shkelje më të gjera ndaj deputetëve të opozitës.

**Pwr kwtw arsye, Partia Popullore Europiane (PPE):**

**Mbështet fuqimisht mbrojtjen e shtetit të së drejtës dhe integritetit institucional si shtylla themelore të një shoqërie demokratike;**

Bën thirrje autoriteteve kombëtare të respektojnë angazhimet e Shqipërisë ndaj të drejtave kushtetuese dhe standardeve demokratike ndërkombëtare, **duke siguruar një mjedis të drejtë dhe të hapur për të gjithë aktorët politikë dhe duke shmangur përndjekjen apo intimidimin e opozitës**, veçanërisht përpara zgjedhjeve;

Kërkon nga qeveria të intensifikojë përpjekjet për të vendosur **përparim të besueshëm dhe transparent në luftën kundër krimit të organizuar, trafikut të drogës dhe pastrimit të parave**, duke siguruar që veprimet të mbeten të paanshme dhe të mos synojnë opozitën;

Shpreh mbështetjen e saj të palëkundur për përpjekjet e **Partisë Demokratike drejt integritit në BE dhe angazhimin e saj për të siguruar zgjedhje të lira dhe të ndershme**, duke njohur rolin e tyre në mbrojtjen e qeverisjes demokratike dhe të drejtave themelore dhe duke nënvizuar të drejtën legjitime të opozitës për protesta paqësore;

I bën thirrje Parlamentit shqiptar të intensifikojë përpjekjet për mbështetjen e Komisionit për **Reformën Zgjedhore**, për të promovuar një Kod Zgjedhor gjithëpërfshirës dhe të plotë, duke theksuar nevojën për të adresuar të gjitha rekomandimet prioritare të OSBE/ODIHR dhe duke nënvizuar se udhërrëfyesi i qeverisë duhet të përfshijë reforma zgjedhore të bazuara në udhëzimet e OSBE/ODIHR;

Kërkon nga autoritetet shqiptare të zbatojnë menjëherë reformat e kërkuara nga BE-ja për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe **për të siguruar një gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm, të lirë nga ndërhyrjet politike;**

Thekson se **zgjedhjet e lira dhe të ndershme përbëjnë shtyllën themelore të qeverisjes demokratike**, duke kërkuar garanci për pavarësinë e administratës publike nga partia në pushtet.

PPE do të monitorojë nga afër zhvillimet në Shqipëri, duke mbështetur partitë anëtare në zgjedhjet e ardhshme dhe duke avokuar për aspiratat e Shqipërisë për në BE. PPE rithekson mbështetjen e saj të fortë për integrimin europian të Shqipërisë dhe përpjekjet e popullit shqiptar për një të ardhme të lirë dhe demokratike.

[1] <https://www.osce.org/files/f/documents/d/d/553972.pdf>

[2] Shqipëria - Transparency.org e rendit Shqipërinë të 98-ën nga 180 vende dhe si vendin më të korruptuar në Europë; një studim i muajit të kaluar tregon se 52% e qytetarëve shqiptarë janë të korruptuar nga administrata shtetërore.

[3] <https://worldjusticeproject.org/rule-of-law-index/country/2024/Albania/> e rendit Shqipërinë në vendin e 106-të nga 142 vende për Kufizimin e Pushtetit të Qeverisë; 107 për Mungesën e Korrupsionit; 114 për Rregullimin dhe Zbatimin; 101 për

Drejtësinë Civile; 92 për Drejtësinë Penale; dhe 106 për Ndërhyrjen Qeveritare në Drejtësinë Penale.

[4] <https://www.state.gov/reports/2023-country-reports-on-human-rights-practices/albania/>